



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 92/ Prot.

Tiranë, më 10.04.2020

**PROCESVERBAL**

Sot, më datën 10.04.2020, ditë e premte, ora 11.00, Këshilli i Lartë i Prokurorisë zhvilloi mbledhjen plenare të rradhës nëpërmjet platformës on-line në lidhje Skype/zoom, thirrur nga Kryetari, bazuar në nenet 164 deri në 167 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar.

Këshilli mbledhet në prani të anëtarëve si më poshtë:

1. Gent Ibrahimi
2. Alfred Balla
3. Nurihan Seiti
4. Tartar Bazaj
5. Bujar Sheshi
6. Kosta Beluri
7. Sandër Beci
8. Esmeralda Keshi
9. Vate Staka

Nga administrata e KLP janë të pranishëm:

- Drejtori i Kabinetit

Mbledhja u zhvillua nën drejtimin e Kryetarit të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, z.Gent Ibrahimi, i cili, në zbatim të nenit 166 të Ligjit Nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë”, i ndryshuar, pasi verifikon pjesëmarrjen e anëtarëve, bën hapjen e saj në kushtet e kuorumit dhe kalon në prezantimin e rendit të ditës:



## **Rendi i Ditës:**

1. Miratimi i projektvendimit “Për kontributin financiar të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë vendin”.
2. Miratimi i projektvendimit “Për miratimin e heqjes dorë të Znj. Anita Jella nga kandidimi si prokurore në Prokurorinë e Posaçme”.
3. Miratimi i projektvendimit “Për shpalljen e një vendi vakant për prokuror në Prokurorinë e Posaçme”.
4. Diskutime lidhur me çështje, të cilat duhet të trajtohen në mbledhjen plenare pasardhëse të Këshillit.

**Z. Ibrahim** pyet nëse ka pyetje dhe komente.

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e parë të rendit të ditës.

- *Miratimi i projektvendimit “Për kontributin financiar të anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore në të gjithë vendin”.*

**Z. Ibrahim**: Përtej angazhimit tonë si qytetarë, Këshilli ka qenë i kujdesshëm që kjo çështje të trajtohet si duhet juridikisht, duke marrë parasysh që paga e magjistratëve është një çështje shumë e rëndësishme. Parë edhe nga pikëpamja kushtetuese, ajo është simbolikë e pavarësisë së sistemit të drejtësisë. Këshilli ka vepruar duke respektuar parashikimet ligjore. Pas një analize të hollësishme të stafit teknik, u mendua që ne si Këshill të dilnim me një vendim unanim, duke shprehur vullnetin e secilit anëtar për këtë dhurim. Kjo është fryma e këtij projektvendimi.

**Z. Ibrahim** lexon: Mbështetur në nenin 149/d të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenet 164/8, 166, 189 të ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në ligjin nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, anëtarët e Këshillit të Lartë të Prokurorisë vendosën në mënyrë unanime për t’iu përgjigjur pozitivisht kësaj nisme, në shenjë solidariteti me qytetarët shqiptarë të prekur nga masat ndaluese të kësaj pandemie, duke përgjysmuar pagën mujore neto të anëtarëve të Këshillit për muajin Prill.

Gjithashtu, përveç kontributit në masën 50% nga paga mujore e anëtarëve të tij, Këshilli i Lartë i Prokurorisë do të vendosë në dispozicion të Ministrisë së Financave, duke rikthyer në Buxhetin e Shtetit, një shumë rreth 7,5 milion lekë nga fondi i pagave, të cilin Këshilli nuk do ta shpenzojë për vitin 2020.

Duke patur parasysh, që ky vendim prek pagën e secilit anëtar, mund të ishte me vend të diskutonim edhe, nëse akti mund të firmoset vetëm nga Kryetari apo duhet firmosuar nga secili prej anëtarëve.



**Z. Ibrahim** shprehet i hapur, nëse ka pyetje dhe komente.

**Z. Staka** u shpreh se është njohur me këtë propozim të Këshillit, si dhe është dakord. Ai propozon që, përveç 50% të pagës së muajit Prill, shuma prej 7.5 milion lekë që Këshilli do të kontribuojë nga fondet e veta, të pasqyrohet në pikë të veçantë.

**Z. Ibrahim** sqaron se, në vendim ndoshta kjo nuk do të pasqyrohet, por në njoftimin për media do të publikohet shifra e saktë.

**Znj. Seiti** shprehet se në kushtet e izolimit dhe distancimit social, është më praktike që vendimi të kalojë vetëm me firmën e Kryetarit, pas marrjes së miratimit nga anëtarët.

**Znj. Keshi** shprehet se vendimi duhet të nënshkruhet nga secili anëtar i Këshillit, duke qenë se prek pagën e magjistratit dhe për këtë arsye nuk mjafton vetëm firma e titullarit. Statusi ynë është “zyrtarë të zgjedhur”, jo të emëruar, të cilëve mund t’u shkojë për zbatim vendimi i titullarit.

**Znj. Seiti** shprehet se ky vendim nuk lidhet me pagën e magjistratit, pasi ky akt është një dhurim.

**Z. Sheshi** u shpreh se, lidhur me mënyrën e marrjes së vendimit për këtë çështje, është diskutuar në mbledhjen joformale të Këshillit. Ai nuk e shikon të nevojshme zgjatjen e diskutimit lidhur me mënyrën e firmosjes dhe është dakord me projektvendimin.

**Z. Ibrahim** pajtohet me mendimin që, pas miratimit, vendimi duhet të firmoset nga të gjithë anëtarët. Më pas hedh në votim miratimin e projektvendimit.

**Miratohet me 9 vota pro.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e dytë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektvendimit “Për miratimin e heqjes dorë të znj. Anita Jella nga kandidimi si prokurore në Prokurorinë e Posaçme”.*

**Z. Ibrahim** referon Vendimin Nr 137 dt.16.07.2019, me anë të cilit Këshilli ka miratuar listën e kandidatëve për prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Në vijim ai lexon projektvendimin për miratimin e heqjes dorë të znj. Jella nga kandidimi si prokurore në Prokurorinë e Posaçme.

Mbështetur në 148/dh të Kushtetutës, nenin 94 të ligjit nr. 44/2015, Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 189/3 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e sipërcituar, pasi u njoh me kërkesën e znj. Anita Jella, dt 26.03.2020, dhe relacionin nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë vendosi: Të miratojë heqjen dorë nga kandidimi për të emëruar prokuror në Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar të znj. Anita Jella. Të



deklarojë të përfunduar procedurën e ngritjes në detyrë për znj. Anita Jella. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e projektvendimit.

**Miratohet me 9 vota pro.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e tretë të rendit të ditës.

- *Miratimin e projektvendimit “Për shpalljen e një vendi vakant për prokuror në Prokurorinë e Posaçme”.*

**Z. Ibrahim** sqaron se, në këto kushte, Këshilli duhet të dalë me një vendim tjetër, atë të shpalljes së një vendi vakant për prokuror pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Ai lexon projektvendimin si më poshtë:

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, mbështetur në nenet 6, 7 të ligjit nr.95/2016 “Për Oganizimin dhe Funksonimin e Institucioneve për të Luftuar Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, në nenin 159 të ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në Rregulloren “Mbi kriteret dhe procedurën për ngritjen në detyrë të prokurorëve pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar, si dhe në Vendimin nr.51 të dt. 10.05.2019, Këshilli vendosi:

Të shpallë fillimin e procedurave për plotësimin e 1 (një) vendi vakant për prokuror në Prokurorinë e Posaçme, përmes procedurës së ngritjes në detyrë; të caktojë Komisionin e Posaçëm për zhvillimin e procedurave për përzgjedhjen e prokurorëve të SPAK, si dhe të ndjekë e të zbatojë procedurat paraprake për plotësimin e kushteve nga kandidatët.

Shprehja e interesit duhet të dorëzohet jo më vonë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kalendarike nga publikimi i shpalljes në faqen zyrtare të institucionit.

**Z. Ibrahim** hedh në votim miratimin e projektvendimit.

**Miratohet me 9 vota pro.**

**Z. Ibrahim** vijon me pikën e fundit të rendit të ditës lidhur me çështje të tjera, të cilat duhet të trajtohen në mbledhjen plenare pasardhëse të Këshillit.

**Z. Ibrahim** informon Këshillin për një ftesë që Prokurori i Përgjithshëm u ka bërë të gjithë prokurorive të Republikës lidhur me kontributin e tyre të mundshëm në kushtet e pandemisë. Ne si Këshill e dhamë modelin, por kjo është një çështje delikate, pasi KLP nuk ka kompetenca që të japë udhëzim në nivel ligjor për këtë çështje.

**Z. Staka** informon për një shkresë të Drejtuesit të Prokurorisë së Shkodrës, ku interesohet lidhur me mënyrat e dhënies së kontributit. Si do të formulohet dokumenti për këtë kontribut? Njëpërmjet një shkrese apo deklarate?



**Z. Sheshi** mendon që dhurimi është një akt personal dhe çdo prokuror, i cili është njohur me vendimin e Prokurorit të Përgjithshëm, do të marrë vendim për pagën e tij. Rasti i Këshillit të Lartë të Prokurorisë është i veçantë, pasi të gjithë anëtarët që e morën këtë vendim, ishin dakord. Për sa i përket prokurorëve, secili duhet të veprojë me nismën e vet, me një deklaratë personale. Lidhur me modalitetet e këtij kontributi, kjo është një çështje teknike që mund të zgjidhet midis titullarit, financierit dhe drejtorit ekonomik të Prokurorisë së Përgjithshme.

**Znj. Keshi** mendon se e vetmja mënyrë për të bërë lëvrimin e shumës, është vetëm pasi paga është disbursuar në llogarinë personale të prokurorit, i cili më pas, nëpërmjet një akti dhurimi, mund ta kalojë në llogarinë e shtetit.

**Z. Bazaj** mendon se i takon Prokurorisë së Përgjithshme të japë një mendim sa më të saktë dhe pajtohet me mendimin e znj. Keshi, se pagat e magistratëve janë të pacënueshme.

**Z. Ibrahim** ndan të njëjtin mendim me z. Sheshi, se mënyra e lëvrimit të kontributit është një çështje teknike.

**Z. Beci** sjell në vëmendje të Këshillit se, në datë 27.04.2020, përfundojnë afatet e disa caktimeve të përkohshme të Drejtuesve të prokurorive pranë Gjykatave të Shkallëve të Para dhe të Apelit, dhe kjo duhet të shqyrtohet në mbledhjen plenare të radhës.

**Z. Staka** i kujton Këshillit përfundimin e afatit të caktimit të përkohshëm, më datën 15 Prill, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Gjirokastrë, z. Gjon Fusha.

**Z. Ibrahim** pajtohet me këtë dhe propozon që mbledhja e radhës të trajtojë dhe dy çështje të tjera:

1. Këshilli të marrë një vendim për transferimin e përhershëm të kancelarit në Prokurorinë e Posaçme, në kuadër të procedurës të transferimit të nëpunësve të administratës, që paraprakisht ishin nëpunës të Prokurorisë së Krimeve të Rënda. Ky proces është kryer përmes një grupi pune, që ka hartuar të gjithë dokumentacionin për transferimin e tyre pranë Prokurorisë së Posaçme në pozicione ekuivalente, me përjashtim të një pozicioni, atë të kancelarit. Kjo lëvizje ka qenë e vështirë për faktin se, e para, kandidatët për këtë pozicion ishin dy zonja; dhe e dyta, për faktin se pozicioni pranë SPAK nuk është 100% i njëjtë me pozicionin e mëparshëm.

Vendimi për emërimin e kancelares në SPAK është një vendim delikat, sepse ka dhe disa paqartësira ligjore. Në këto kushte, Këshilli do t'i duhet pak kohë. Grupi i punës ka hasur vëshirësi dhe, për këtë arsye, i ka kërkuar mendim Komisionerit të Shërbimit Civil dhe nga Departamenti i Administratës Publike. Më pas, grupi i punës do t'i propozojë Këshillit emërimin e njërit prej dy kandidaturave.

2. Krijimi dhe administrimi i dosjes personale së prokurorëve të Republikës. KLGJ e ka marrë prej kohësh këtë vendim. Projektvendimi do t'u vihet në dispozicion anëtarëve që sot, në mënyrë që Këshilli të mund të marrë një vendim më 15 Prill.

**Z. Beluri** i kërkon Këshillit që, në mbledhjen e datës 24 Prill, të futet në rendin e ditës edhe shqyrtimi i raporteve për vetingun e magistratëve.



**Z. Ibrahim** referon kërkesën e bërë nga përfaqësuesja e EURALIUS-it, lidhur me grupet e punës për hartimin e Rregullores së Brendshme të Këshillit për lëvizjen paralele dhe atë të ngritjes në detyrë.

**Znj. Keshi** bën me dije se grupi i punës për hartimin e Rregullores për Lëvizjen Paralele dhe atë të Ngritjes në Detyrë, është pothuajse gati, por sqaron se ka disa pika për diskutim.

**Z. Beluri** thekson se metodologjia është një pikë shumë e rëndësishme e Rregullores, prandaj kërkon vëmendje.

**Z. Ibrahim** propozon që, në shqyrtimin e dosjeve për kandidatët për në SPAK, të përfshihen edhe këshilltarët, përveç anëtarëve të Komisionit të Posaçëm.

Me këtë rast, ai shpreh nevojën dhe emergjencën për caktimin e dy prokurorëve të rinj pranë Këshillit të Lartë të Prokurorisë.

Në përfundim, duke mos patur pika të tjera për diskutim, Kryetari e deklaroi mbledhjen të mbyllur.

#### **Mbajtësi i procesverbalit**

(Sonila Çeliku)



**KRYETARI**

**Gent Ibrahim**



**Shënim:**

**(Shënimi i mëposhtëm vendoset pas përfundimit të të gjithë procedurave të rishikimit)**

Lidhur me këtë procesverbal janë/nuk janë vënë në dukje pasaktësi nga anëtarët e KLP-së. Pasaktësitë e vërejtura janë reflektuar me urdhër të kryetarit Nr. \_\_\_ Datë \_\_\_ 2020/me vendim të Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr. \_\_\_ datë \_\_\_ (Bashkëngjitur kopjet e dokumenteve) Procesverbali i mësipërm u miratua në mbledhjen e radhës të KLP-së datë \_\_\_ / \_\_\_ /2020  
Procesverbali të arkivohet.

**PËRGJEGJËSI I SEKTORIT TË SHËRBIMEVE ADMINISTRATIVE**

**Frederik Sulisufi**

